

## RAPORTI I TAKIMIT VJETOR TË KUVENDIT TË ANËTARËVE

<b>Data dhe vendi</b>	20 dhjetor 2013, Prizren (zyra e EC Ma Ndryshe)
<b>Pjesëmarrësit</b>	<i>Anëtarët:</i> Taulant Gutaj, Besar Haxhibeqiri, Arnet Haskuka, Venera Goxha, Ajtene Krasnqi, Besart Lumi, Kreshnik Basha, Dren Marseli, Enver Batiu (kryesues i Kuvendit të Anëtarëve). Flaka Siqeca dhe Aliriza Arënlju i dërguan votat e tyre paraprakisht përmes emailit  <i>Stafi i organizatës:</i> Hajrulla Çeku (drejtor ekzekutiv), Admir Istrefi (koordinatori i financave), Valon Xhabali (koordinatori programi)
<b>Agjenda e takimit</b>	Hapje e takimit dhe mirëseardhje për anëtarët e ri të Kuvendit Prezantimi i raporteve të punës dhe financiare për vitin 2013 Diskutime mbi raportet e vitit 2013 dhe miratimi i tyre Prezantim i Planit të Punës dhe projektimit financiar për vitin 2014 Diskutime mbi Planin e Punës dhe projektimin financiar 2014 dhe miratimi Rishikimi i dokumenteve të qeverisjes së brendshme të organizatës Çështje operationale të organizatës Mbyllja e takimit

### *Hapje e takimit dhe mirëseardhje për anëtarët e ri të Kuvendit*

Pjesa hyrëse e takimit: falenderimet për anëtarët e ri të organizatës, prezantim për rolin e Kuvendit të Anëtarëve dhe paraqitja e agjendës së takimit vjetor.

### *Prezantimi i raporteve të punës dhe financiare për vitin 2013*

Raport vjetor i punës për vitin 2013 u prezantua nga drejtori ekzekutiv i organizatës. Ky raport përfshin: projektet e realizuara gjatë vitit, iniciativat dhe aktivitetet e tjera, publikimet, partneritetet dhe të arriturat e punës një vjeçare. Pas raportit vjetor të punës, koordinatori i financave i organizatës e prezantoi raportin vjetor financiar. Ky raport përfshin: të hyrat gjatë vitit 2013 në bazë të projekteve/donatorëve (165,615.57 EUR), shumat e përgjithshme të projekteve të miratuara gjatë vitit 2013 (225,829.95 EUR), shpenzimet detaje gjatë vitit 2013 (135,828.10 EUR) dhe gjendjen aktuale në xhirlogarinë e organizatës në fund të vitit (29,786.90 EUR).

### *Diskutime mbi raportet e vitit 2013 dhe miratimi i tyre*

Prezantimi i raportit të punës dhe atij financiar u pasua me diskutim të anëtarëve të Kuvendit. Kreshnik Basha sugjeroi që në raportin vjetor të punës, në fund të secilit projekt të figurojë/tregohet edhe shuma totale e projektit, ndërsa Arnet Haskuka kërkoi që praktika e organizatës me realizim të raporteve vjetore të auditimit financiar të vazhdojë dhe të jetë ndër prioritetet kryesore të organizatës. Koordinator i financave i organizatës sqaroi se raporti i auditimit për vitin 2013 do të përfundojë dhe publikohet deri në shkurt të vitit 2014.

Pas diskutimeve rreth të dy raporteve, anëtarët e Kuvendit votuan veç e veç për secilin prej këtyre raporteve. Me votat PËR të të gjithë anëtarëve prezant (dhe dy anëtarëve që i kanë dërguar votat e tyre përmes emailit), në votime të veçanta, u miratuan Raporti Vjetor i Punës 2013 dhe Raporti Financiar 2013. Të dyja dokumentet (raportet), në formën e tyre përfundimtare të miratuara nga Kuvendi i Anëtarëve dhe të nënshkruhen nga Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve (në emër të Kuvendit të Anëtarëve) dhe drejtori ekzekutiv i organizatës (në emër të stafit të EC Ma Ndryshe) dhe do të publikohen në web-faqen e organizatës.

#### *Prezantim i Planit të Punës dhe projektimit financiar për vitin 2014*

Plani i Punës për vitin 2014 u prezantua nga drejtori ekzekutiv i organizatës. Plani propozon që gjatë vitit 2014:

- Të punohet për arritjen e objektivit të përgjithshëm: angazhim për qeverisje demokratike si parakusht i zhvillimit të qëndrueshëm lokal në Prizren dhe komunat e tjera ku punon dhe do të punojë organizata,
- Të aplikohet qasja strategjike e thellimit (profesionalizimit të mëtejshëm) në projektet aktuale dhe potencialisht, zgjerimit të tyre edhe në komunat e tjera (pasi që ato janë pilotuar në Prizren),
- Të shtohet komponenta e hulumtimeve, e cila do të fillojë të ndërtohet si programi i tretë, krahas pjesëmarrjes qytetare dhe trashëgimisë kulturore,
- Të realizohet gjithsej nëntë (9) projekte, përfshi projektet aktuale të organizatës dhe disa të reja,

Pas prezantimit të planit të punës, koordinatori i financave i organizatës e shpali projektimin financiar për vitin 2014. Sipas këtij plani me shtatë kategori të gjëra buxhetore, organizata synon të realizojë buxhet vjetor pre 252,644.00 EUR gjatë vitit 2014.

#### *Diskutime mbi Planin e Punës dhe projektimit financiar 2014 dhe miratimi i tyre*

Prezantimi i planit të punës dhe projekcionit financiar për vitin 2014 u pasua me diskutim të anëtarëve të Kuvendit. Përqendrimi i diskutimit ishte në nevojën e planifikimit më afatgjatë se sa një vjeçar. Pas diskutimeve rreth të dy dokumenteve, anëtarët e Kuvendit votuan veç e veç për secilin prej tyre. Me votat PËR të të gjithë anëtarëve prezant (dhe dy anëtarëve që i kanë dërguar votat e tyre përmes emailit), në votime të veçanta, u miratuan Plani (Programi) i Punës 2014 dhe Projektimi financiar 2014. Të dyja dokumentet, në formën e tyre përfundimtare të miratuara nga Kuvendi i Anëtarëve dhe të nënshkruhen nga Kryesuesi i Kuvendit të Anëtarëve (në emër të Kuvendit të Anëtarëve) dhe drejtori ekzekutiv i organizatës (në emër të stafit të EC Ma Ndryshe) dhe do të publikohen në web-faqen e organizatës.

#### *Rishikimi i dokumenteve të qeverisjes së brendshme të organizatës*

Diskutimi mbi dokumentet e qeverisjes së brendshme përfundoi me konstatimin se organizata për momentin nuk ka nevojë të ndryshojë përmbajtjen e këtyre dokumenteve. Megjithatë, nevojën për ndryshimin e këtyre dokumenteve mund ta përcaktojë procesi i hartimit të strategjisë afatgjatë të organizatës. Gjatë vitit 2014, me sugjerimin e Kreshnik Bashës u diskutua mundësia që organizata të prodhojë një manual të brendshëm që do t'i përfshijë të gjitha dokumentet e qeverisjes së brendshme. Në këtë proces, do të shtohet edhe mundësia e hartimit të dokumenteve tjera (si Kodi i Etikës). Pikat 3.1 dhe 3.2 të statutit të organizatës, të cilat flasin për qëllimet dhe fushat e veprimit mund të jenë subjekt i rishikimit gjatë takimit të ardhshëm të Kuvendit të Anëtarëve.

### *Diskutime dhe vendime të tjera*

- Në çdo takim të rregullt vjetor, Kuvendi i Anëtarëve do të zgjedhë një kryesues, i cili do të udhëheqë takimin dhe do t'i nënshkruaj vendimet në emër të Kuvendit të Anëtarëve. Kjo pozitë do të mbahet nga anëtari kryesues deri në takimin e ardhshëm të rregullt vjetor të Kuvendit të Anëtarëve, ku do të zgjedhet kryesuesi i ri.
- Me votat e të gjithë anëtarëve prezent, Enver Batiu u zgjedh kryesues i Kuvendit të Anëtarëve të organizatës për takimin e rregullt vjetor të vitit 2013.
- Të gjitha dokumentet e miratuara në Kuvendin e Anëtarëve duhet të nënshkruhen dhe të publikohen në web-faqen e organizatës.
- Organizata duhet të shqyrtojë mundësinë për të aplikuar për certifikim për ISO standarde për organizatat.
- Organizata duhet të konsiderojë edhe ofrimin e shërbimeve të caktuara, si aktivitet shtesë dhe burim alternativ të të ardhurave.
- Hartimi i strategjisë afatgjatë është domosdoshmëri. Në janar të vitit 2014, stafi i organizatës do të ndajë një draft fillestar të dokumentit strategjik (3-5 vjeçar) me të gjithë anëtarët dhe Bordin e organizatës.
- Duhet të rishikohet dhe verifikohet terminologjia "opinion i kualifikuar" në raportin e auditorit për vitin 2012, për t'u siguruar për saktësinë e këtij emërtimi,
- Rritje e aktiviteteve në Prishtinë duhet të parashihet në orientimin strategjik të organizatës për vitet e ardhshme.
- Manuali i dokumenteve të qeverisjes së brendshme, në formën e draftit, do të ndahet me të gjithë anëtarët dhe Bordin e organizatës deri në fund të muajin janar 2014.
- Anëtarët e organizatës do të njoftohen për punën e organizatës përmes raporteve të rregullta narrative dhe financiare të cilat do t'i pranojnë nga drejtori ekzekutiv.